



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Sokol Haliti, Kryetar i Komunës së Vitisë Bekim Azizi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Erblin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor, MAPL	Datë: 21.04.2026 -VI- 020-246
Zyrtarët përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit Maltin Shala, Zyrtar i Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit	
Lënda:	Konfirmim i Ligjshmërisë	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë aktin e komunës si në vijim:

Vendimin Nr. 01-110/05-382, për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

I miratuar më datë: 30.03.2026

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 01.04.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në pajtim me legjislacionin në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

ARSYETIM

Vendimi Nr. 01-110/05-382, për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

MAPL, konstaton se akti i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Vitisë, është bazuar në nenin 12, paragrafi 1, shkronja d) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 17, paragrafi 2 dhe 6 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 17, paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Vendimi është miratuar në mbledhjen e mbajtur të datës 30.03.2026, i miratuar me 25 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Za :	Sokol Haliti, gradonačelnik opštine Vitina Bekim Azizi, predsedavajući Skupštine opštine Vitina	
Kopija:	Jedinica za administraciju dokumentacije u MALS-u Jedinica za administraciju dokumentacije u opštini	
Preko:	Elbert Krasniqi, ministar MALS-a, Jeton Qela, generalni sekretar u MALS-u	
Od:	Erbilin Hetemi, direktor Pravnog odeljenja, MALS	Dana: 21.04.2026 -VI- 020-246
Službenik-ca: za utvrđivanje pravne procene:	Xhevat Tafa, rukovodilac odeljenja za razmatranje zakonitosti akata i akata gradonačelnika opštine rukovodilac odeljenja za monitorisanje opština.	
Službenik-ca: za izradu pravne procene:	Maltin Shala, Viši službenik za razmatranje zakonitosti akata opštine i akata predsednika opštine	
Predmet:	Potvrda zakonitosti	
Vrsta akta:	Odluka	

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsedavajući,

U skladu sa članovima 8 i 9 Zakona br. 08/L-284 o Administrativnom preispitivanju akata opština i Uredbom (VRK) br. 03/2026 o Postupku administrativnog preispitivanja akata opština, a na osnovu zakonskih nadležnosti Ministarstva utvrđenih osnovnim zakonima i Uredbom (VRK) br. 04/2026 o Oblastima administrativne odgovornosti ministarstava, Ministarstvo administracije lokalne samouprave je primilo na obavezno razmatranje zakonitosti sledeći akt opštine:

Odluku br. 01-110/05-382, o formiranju komisije za sprovođenje procedura i ocenjivanje ponuda za davanje na korišćenje nepokretne imovine opštine.

Usvojena dana, 30.01.2026.

Podnešena na razmatranje u MALS-u dana, 01.04.2026.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja akta opštine kao gore navedenog, ocenjuje da je akt opštine u skladu sa važećim zakonodavstvom i kao takav može proizvesti pravne efekte.

Obrazloženje

Odluku br. 01-110/05-382, o formiranju komisije za sprovođenje procedura i ocenjivanje ponuda za davanje na korišćenje nepokretne imovine opštine.

MALS, konstatuje da je akt usvojen od strane Skupštine opštine Vitina zasnovan na članu 12, stav 1, tačka d) Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi, članu 17, stav 2 i 6 Zakona br. 06/L-092 o davanju na korišćenje i razmeni nepokretne imovine opštine, kao i na članu 17, stav 1 i 2 Uredbe (VRK) br. 09/2020 o utvrđivanju procedura za davanje na korišćenje i razmenu nepokretne imovine opštine.

Odluka je usvojena na sednici održanoj dana 30.03.2026, sa 25 glasova za, 0 protiv i 0 uzdržanih.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za sva dodatna pojašnjenja u vezi sa ovom procenom.